

Raport Mujor për fondin Credins Premium

Fondi Credins Premium ka objektiv të maksimizojë të ardhurat tuaja, duke ruajtur principalin dhe likuiditetin. Portofoli i Fondit CREDINS PREMIUM, në përputhje me Politikën e Investimit, do të përbëhet kryesisht nga obligacione dhe bono të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë të denominuara në Lek, si dhe mjete monetare dhe ekuivalente të tyre në bankat e nivelit të dytë.

Data e raportit: 31.12.2022

Informacion për Fondin

Shoqëria Administruese e Fondit:	Credins Invest
Data e lançimit të fondit:	01 Korrik 2016
Monedha e Fondit:	Lek

Fondi i adresohet investitorëve që kërkojnë:

- ✓ një normë kthimi më të lartë se produktet bankare,
- ✓ likuiditetin që i mungon këtyre produkteve.

Profili i rrezikut dhe përfitimit

Ecuria e normës së kthimit të Fondit varet nga lëvizja e normave të interesit të bonove dhe obligacioneve të Republikës së Shqipërisë. Pavarësisht luhatjeve të përkohëshme, historikisht këto norma kanë treguar luhatshmëri të ulët.

Rrezik i ulët		Rrezik i lartë				
Përfitimet tipike më të ulëta		Përfitimet tipike më të larta				
1	2	3	4	5	6	7

Fondi CREDINS PREMIUM ka një profil rreziku në nivelin 2, pra të ulët.

Të dhëna kryesore për Fondin

Vlera Neto e Aseteve	880,087,329.09
Çmimi i kuotës	1,265.6788
Kohëzgjatja e Modifikuar	0.06 vjet
Kthimi nga investimi (31.12.2021 - 31.12.2022)*	-6.77 %

* Tarifa e administrimit është zbritur përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

Karakteristikat e rrezikut të asetëve në Fond

Depozitat Bankare

Depozita Bankare si klasë asetë përmban rrezikun e kredisë së bankës dhe rrezikun e riçimit në momentin e maturimit të saj. Rreziku i riçimit nënkupton uljen e normës së interesit kur depozita rivendoset me të njëjtin maturitet.

Obligacionet dhe Bonot Qeveritare

Këto asete janë të emetuara nga Qeveria, agjencitë apo ndërmarrje të sponsorizuara nga Qeveria. Megjithatë, qeveritë nuk garantojnë pagesën e interesit apo principalit. Obligacionet apo Bonot qeveritare janë subjekt i rrezikut nga normat e interesit dhe kanë nota krediti ("rating") të ndryshme. Bonot përmbajnë rrezik nga interesat më të lartë se obligacionet me të njëjtën kohë deri në maturim.

*Për më tepër informacion rreth rreziqeve të Fondit, ju lutem referojuni seksionit përkatës në Prospektin e Fondit Credins Premium.

Kostot dhe Pagesat


Pagesat përdoren për të paguar kostot e administrimit të Fondit, duke përfshirë kostot e marketingut dhe shpërndarjes së kuotave të Fondit. Pagesat që kryhen çojnë në ulje të rritjes potenciale të investimit.

Tarifa e hyrjes apo daljes	0%
Tarifa e administrimit	1% në vit e VNA të Fondit
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave	0 Lekë
Kosto të tjera:	
Kosto të transaksioneve për investimin e asetëve të fondit	sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese
Tarifa e auditimit vjetor të fondit	sipas kushteve të punës së kompanisë së auditit
Tarifa e depozitarit	0.1836% në vit e VNA
Tarifa e AMF	0.05% në vit e VNA

Shpërndarja e Instrumenteve si përqindje e Aseteve Totale të Fondit

Shpërndarja e Instrumenteve	ALL	%Aseteve
Obligacione	4,174,841.39	0.47%
Bono Thesari	46,602,131.05	5.21%
Mjete monetare dhe ekuivalente të tyre	843,775,200.18	94.32%

Shpërndarja e Instrumenteve sipas Llojit




Ankandet e titujve qeveritarë dhe normat e interesit

Qeveria e Republikës së Shqipërisë emeton letrat me vlerë në periudha relativisht të rregullta dhe të shpeshta. Në përputhje me materialet informuese të publikuara nga Ministria e Financave, ankandet për bonot e thesarit me afat 3-mujor dhe 6-mujor organizohen një herë në muaj, ndërsa ato 12-mujore organizohen çdo dy javë. Duke përfshirë ankandet e obligacioneve 2-vjeçare, të cilat zhvillohen një herë në muaj, ankandet e obligacioneve të tjera (3,5,7,10 dhe 15-vjeçare) zhvillohen me një frekuencë të përafërt prej 3 muajsh.

Viti 2022, duke filluar nga muaji mars pas rritjes së parë të normës bazë nga Banka e Shqipërisë, u karakterizua nga një rritje tepër e lartë e normave të interesit të titujve qeveritare (BTH dhe obligacione), të cilat nuk kishin arritur këto nivele që nga viti 2014. Banka e Shqipërisë gjatë vitit 2022 ka realizuar 5 rritje të normës bazë duke sjellë nga niveli 0.5%, në të cilin qëndronte që nga muaji mars 2020, në nivelin 2.75%. Rritja e normës bazë u kushtëzua nga rritja e lartë e inflacionit në vend përkatësisht nga niveli 3.7% në dhjetor 2021 në nivelin 7.4% në mbyllje të vitit 2022. Rritja e normës bazë të interesit është reflektuar në mënyrë të ndjeshme dhe të menjëhershme në normat e titujve të QSH në të gjitha maturitetet, siç mund të vihet re edhe nga kurba e ecurisë së yield-eve për vitin 2022. Ecuria në rritje e normave të interesit të titujve ka ndikuar negativisht ecurinë e çmimit të titujve që Fondi Credins Premium zotëronte në portofolin e investimeve, duke sjellë një kthim negativ vjetor, për herë të parë që nga themelimi i tij.


Ndryshe nga sa pritej, BSH nuk e rriti normën bazë gjatë muajit Dhjetor 2022, nisur nga tendenca në rënie të lehtë të nivelit të inflacionit, krahasuar me muajt e mëparshëm. Kjo impaktoi ecurinë e normave të interesit të titujve afatshkurtër, të cilët gjatë muajit Dhjetor rezultuan kryesisht me ulje për shkak të mbulimit të lartë në ankande.

Ecuria e yield-eve të Bonove 3, 6 dhe 12-mujore



Rezultati i ankandit të datës 6 dhjetor i bonos 3-mujore rezultoi me rritje të ulët nga 2.907% në 3.13%. Rezultati i ankandit të BTH 12 M në datë 27 Dhjetor rezultoi me ulje nga 5.8% në 5.47%.

Ecuria e yield-eve të Obligacioneve



Gjithashtu, yield-i i obligacionit 2-vjeçar rihapje, rezultoi me ulje nga 6.48% në 6.24%. Ankandi i obligacionit referencë 3-vjeçar në datë 20 dhjetor, rihapje, rezultoi me rritje të lehtë në 6.29% nga 6.145% që ishte në muajin Tetor 2022. Ankandi i obligacionit 7-vjeçar, ri-hapje, në datë 14 dhjetor, rezultoi me rritje nga 6.88% që ishte në muajin Shtator, në 7.98%, duke marrë në këtë mënyrë të gjithë spread-in e muajve që nuk ka patur ankand 7-vjeçar dhe ribalancuar kurbën e yield-it. Gjatë muajit dhjetor nuk u zhvilluan ankande për obligacionet 5-vjeçar, 10-vjeçar dhe 15-vjeçar. Sa i përket ndryshimeve ditore të obligacioneve reference 3-5 vite, gjatë muajit Dhjetor trendi ka rezultuar rënës i lartë për herë të parë që prej muajit Mars. Ndryshimet e yield-it ditore të kuotuar për këto obligacione nga 30 Nëntor në 31 Dhjetor janë si në vazhdim: për 3-vjeçarin nga 7% në 5.8%, për 4-vjeçarin nga 7.7% në 6.39% dhe për 5-vjeçarin nga 7.9% në 6.85%.


Kthimi vjetor neto historik

Asetet e Fondit janë kryesisht të investuara në titujt e emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, dhe si rrjedhojë ecuria e normës së kthimit të Fondit ndikohet nga lëvizja e normave të interesit në ankandet e titujve të Qeverisë Shqiptare.

Fondi regjistron obligacionet dhe bonot në portofol sipas vlerës së drejtë, që do të thotë kryen vlerësimin e tyre të tregut çdo ditë. Çmimi i obligacioneve dhe i bonove ka një lidhje të zhdrejtë me normat e interesit. Kur normat e interesit në treg rriten, çmimi (vlera) e obligacioneve dhe bonove të mëparshme ulet dhe për rrjedhojë ulet dhe norma e kthimit për periudhën e kaluar. E kundërta ndodh kur normat e interesit ulen.

Kthimet neto të Fondit nga themelimi deri më 31 dhjetor 2022 sipas periudhave të ndryshme, janë paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Periudha e qendrimit	Kthimi vjetor i periudhës
1 vjeçare	-6.77% në vit
2 vjeçare	-1.34% në vit
3 vjeçare	-0.43% në vit
4 vjeçare	0.94% në vit
5 vjeçare	2.16% në vit
Që nga themelimi	3.16% në vit




Fondi ka filluar aktivitetin më **1 Korrik 2016**. Norma neto vjetore përfaqëson normën e kthimit të portofolit pasi janë zbritur kostot dhe tarifat që i mbahen fondit. Të dhënat historike paraqiten për qëllime ilustrative dhe nuk duhet të konsiderohen si garanci për të ardhmen.

Masat e Bankës së Shqipërisë për frenimin e inflacionit priten të vazhdojnë gjatë vitit 2023. Sipas parashikimit të Bankës së Shqipërisë, inflacioni pritet të jetë në trajektore rënëse gjatë vitit 2023 dhe të arrijë objektivin gjatë vitit 2024. Përballë situatës në rritje të normave, Shoqëria Administruese gjatë vitit 2022 ndërmori një proces ri-alokimi taktik të aseteve duke u pozicionuar në instrumente afatshkurtër, për të ulur impaktet negative nga rezultatet e ankandëve. Ky proces është zhvilluar duke konsideruar gjithmonë interesin më të mirë të investitorëve dhe me efekt sa më të ulët për ta. Në vijim të këtij procesi ri-alokimi taktik të aseteve, Fondi është pozicionuar në më shumë se 90% të aseteve në instrumenta afatshkurtër dhe mjete monetare e ekuivalente të tyre në mbyllje të vitit 2022.

Këto mjete do të alokohen në mënyrë konservative në tituj të maturiteteve të ndryshme nga Shoqëria duke synuar maksimizimin e normës së kthimit dhe reduktimit të goditjeve negative nga ecuria e normave të interesit gjatë vitit 2023.

Pavarësisht luhatshmërisë së lartë që kanë patur normat e titujve të borxhit të shtetit shqiptar gjatë vitit 2022, profili i riskut të Fondit Credins Premium mbetet në nivelin 2.

Duke konsideruar sa më lart, investitorët e Fondit inkurajohen të jenë të duruar, të mos bëjnë disinvestime të ndikuara nga kushtet e pafavorshme të tregut dhe të kenë një qasje të orientuar në vlerën afatgjatë të investimeve të tyre.



Performanca e kaluar nuk është një udhëzues, premim apo garanci për performancën e ardhshme dhe nuk duhet të jetë faktori i vetëm i shqyrtimit gjatë zgjedhjes së një produkti. Të gjitha investimet financiare përfshijnë një element të rrezikut. Prandaj, vlera e investimit tuaj dhe të ardhurat nga ajo do të ndryshojnë. Nivelet dhe bazat e taksimit mund të ndryshojnë herë pas here. Për informacion shtesë, jeni të ftuar të lexoni Prospektin e Fondit si dhe të vizitoni faqen zyrtare të shoqërisë www.credinsinvest.com.